

VENDIM
Nr. 565, datë 29.7.2022

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE TE MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL, TË DISA OBJEKTEVE DHE SIPËRFAQE TRUALL FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS ME NUMËR 90, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 4400 (ISH-SHTABI I KML-së), ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, pika 4, 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 25-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të një sipërfaqeje të përgjithshme 3 035.6 (tre mijë e tridhjetë e pesë pikë gjashtë) m², sipas plan-rilevimit dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ta përdorur për ambiente zyrash për Institutin e Ndërtimit.

2. Dhënien në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 25-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të një sipërfaqeje të përgjithshme 611 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë) m², sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse të tij, për ta përdorur për ambiente zyrash për institucionet e varësisë.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin atë në përdorim të tretëve.

4. Vendimi nr. 277, datë 1.4.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të disa objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3 035.6 m², brenda territorit të pronës me numër rendor 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (ish-shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona Nr. 90 "Ish Shtabi i KML-së" Brar, Tiranë

PRONARI: MINISTRIA E MBROJTJES, AFA DATË: 29/07/2022 QËLLIMI: Për dhënjë në përdorim

VENDNDODHJA

Bashkia: Tiranë DVASHK/ZVASHK: Tiranë Nr.Pasurisë: 3/4 Z.K: 8110 Indeksi i Hartës TR:C,D-17,18


TE DHËNAT E PASURISË

Lloi i pasurisë: Truall Sip e pasurisë: 3493.6 m² Sip e gjurmës së ndërtimit: 1402.3 m² Nr. kateve: 1;3 Nr. pemeve: _____

Nord = 4580576.734
East = 487428.754

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4580576.734
East = 487604.717



Nord = 4580436.306
East = 487428.754

SH 1: 1000

Nord = 4580436.306
East = 487604.717

NRI	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	NIPT I IGJIU
1	Vend			3/1, 3/4	K51728024H
2	Lindje			3/4	
3	Jug			3/3	
4	Perëndim			3/1	

REALIZOI PËR IGJIU:

Specialist : Nikoll TUSHI

Nënshkrimi

KONFIRMOI PËR IGJIU:

DREJTORI MACH. Teuta KANXHERI

Nënshkrimi

REALIZOI PËR ASHK

Specialisti

DVASHK

Nënshkrimi

KONFIRMOI

Përgjegjësi/Drejtori

Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE

Kodet për teknologjinë e matjeve: Z, O, D

SHËNIME TË VEÇANTA:

Ky plan rievimi u hartua në zbatim të email të SHPFA, bazuar në dokumentacionin hartografik të kësaj prone hartuar në vite, të marrë nga Arkivi i IGJIU. Në Objektin nr.2 433.1 m² objekt dhe 24.9 m² truall, (458 m²) me VKM nr. 570, datë 03.08.2016, dhënë në përdorim MIE (IN), me VKM nr.277, datë 01.04.2015, sip. 3035.6 m², ku përfshihen pjesa e ngjatur nga objekti nr.2, obj. nr.3 dhe obj.nr.1 i kanë kaluar në përdorim Ministrisë së Bujqësisë. Me VKM nr.426, datë 08.06.2016, kati përdhe i Obj. nr.1, me sip.681.5 m² dhënë MIE (IN), duke ja hequr nga përdorimi MB. Kati i parë me Sip.611 m², kërkohet të kalohet në përdorim nga MB tek MIE (IN). Prona është e rrethuar me mure pjeserish dhe me kangjella metalike pjesa pjesë.

PËRCAKTIMI I KUFIRIT

Kodet për Përcaktimin e kufirit: P, HK

MIRATOHET

KOMANDANTI I AFA


General Brigadë Albert MULLAI

PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.1 KATI PERDHE

Prona nr.90 (Ish Shtabi i KML)

SHKALLA 1:150

SIP = 681,5 m²




REP. SHQIPERISE MIN. MBROJTJES I GJILU. Prona nr.90 "Shtabi i KML", Tirane Korrik 2022	DRETTORI	MARCH. TEUTA KANXHERRI
	VIZATOI	TOPOGRAF NIKOLL TUSHI
	PERPILOI	TOPOGRAF RAMIZ HAXHIU

PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.1 KATI PARË

Prona nr.90 (Ish Shtabi i KML)

SHKALLA 1:150

SIP = 611.0 m²





REP. SHQIPERISE MIN. MBROJTJES I GJ.I.U.	DREITORI	MARCH. Teuta KANXHERI
Prona nr.90 "Shtabi i KML", Tirane	VIZATOI	Topograf Nikoll TUSHI
Korrik 2022	PERILOI	Topograf Ramiz HAXHIU

PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.1 KATI DYTË

Prona nr.90 (Ish Shtabi i KML)

SHKALLA 1:150

SIP = 611.0 m²



REP.SHQIPERISE MIN. MBROJTJES IGJIU Prona nr.90 "Shtabi i KML", Tirane Korrik 2022	DREJTORI	MARCH. Teuta KANXHERI
	VIZATOI	Topograf Nikoll TUSHI
	PERPILLOI	Topograf Ramiz HAXHIU